



## VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16  
dhe 2014-17

D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R.

kundër

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 19 TETOR 2016**

1. Me një vendim të 19 tetor 2016, Paneli ka konstatuar se të drejtat e ankuesve ishin shkelur nga Misioni dhe ka rekomanduar që shefi i Misionit ("ShM") duhet të zbatoj masat e mëposhtme për t'i trajtuar këto shkelje:

#### **"PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJËZËRI,**

1. *Konstaton* se ka pasur shkelje të neneve 2 dhe 3, dhe nenit 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës.

2. *Gjen* të përshtatshme, në dritën e gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit që të bëjë rekomandimet e mëposhtme për shëfën e Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së Punës:

*“Gjen* të përshtatshme, në dritën e gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit që të bëjë rekomandimet e mëposhtme për shëfën e Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së Punës:

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë që pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses, që i ngarkohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv;
- b. ShM-ja duhet t’ju komunikojë dhe transmetojë këtë vendim të gjitha organeve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të Misionit.
- c. Duke vepruar këtë, ShM-ja duhet t’i udhëzoj të gjitha organet e Misionit që janë në kontakt me viktimat e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në kuadër të zhdukjeve të detyruara për të siguruar që në të gjitha komunikimet me ta, ata të komunikojnë me shpejtësinë, zellin e duhur dhe kujdesin e nevojshëm, për të marrë parasysh shqetësimin emocional të bashkëbisedues(ve)it të tyre. Nëse është e nevojshme, ShM-ja duhet të konsideroj zbatimin e udhëzimeve të cilat përcaktojnë në mënyrë më të hollësishme se çfarë mund të nënkuptojnë ky udhëzim i përgjithshëm në rrethana konkrete.
- d. ShM-ja duhet t’i udhëzoj organet hetimore të EULEX-it mbi rëndësinë e rasteve të zhdukjeve që vazhdojnë të jenë prioritet i hetimeve në mënyrë që ato të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe se kudo që të dyshuarit të identifikohen të sillen para drejtësisë menjëherë dhe në mënyrë të drejtë.
- e. Më tej ShM-ja ftohet që autoriteteve kompetente hetuese dhe prokuroriale në kuadër të Misionit t’iu tërheq vëmendjen kah faktorët e cekur më sipër si relevante për kompetencat e “jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it dhe për t’i njohur ata me rëndësinë e marrjes parasysh të këtyre faktorëve në vlerësimin e tyre nëse duhet që ata të kërkojnë të marrin përsipër përgjegjësinë mbi këtë lëndë. Paneli pret që do të bëhet një shqyrtim i këtyre lëndëve në bazë të këtyre parametrave në mënyrë që të sigurohet se autoritetet hetimore dhe prokuroriale do të marrin një vendim të mirëinformuar dhe ligjërish të

arsyeshëm në lidhje me nevojën për të hetuar disa apo të gjitha këto lëndë.

- f. Paneli është plotësisht i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë që rezultojnë nga reduktimi i burimeve të Misionit për shkak të rikonfigurimit. Megjithatë, brenda kufijve të këtyre burimeve dhe në mënyrë proporcionale me rëndësinë që Misioni i jep mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, Paneli fton ShM-në të siguroj që organet hetuese brenda Misionit të kenë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme dhe mbështetjen për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve.

2. Kompetencat dhe autoriteti i Panelit për të vazhduar me vendimet dhe rekomandimet e tij është paraparë në rregullën 45 e *tutje* të Rregullores së Punës së Panelit (për shembull shih vendimet mbi zbatimin e rekomandimeve *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 26 gusht 2014; *Becić kundër EULEX-it*, 2013-03, 11 nëntor 2015).

## **II. INFORMACIONI I MARRË NGA SHEFJA E MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

3. Përmes një letre të datës 29 nëntor 2016, ShM-ja ka njoftuar Panelin rreth hapave dhe masave të ndërmarra në zbatimin e rekomandimeve të Panelit.

## **III. VLERËSIMI NGA PANELI**

4. Lidhur me rekomandimin e parë të Panelit (shih më lartë par. 1(a)), Paneli vëren me keqardhje se kjo ka qenë praktikë e vazhdueshme e Misionit që të refuzojë apo që mos të pranoj zyrtarisht përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit, aty ku Paneli ka konstatuar se ajo kishte ndodhur. Një pranim i tillë do të ofronte një formë të drejtë të shpërblimit në një lëndë si kjo për të korrigjuar gabimin e bërë ndaj ankuesit nga ana e Misionit. Kjo formë e lehtësimit është edhe më e rëndësishme në kontekstin e tanishëm pasi që Paneli nuk lejohet të rekomandojë ndonjë lloj dëmshpërblimi monetar për të kompensuar dëmin shkaktuar ankuesit.
5. Në lidhje me rekomandimin që ShM-ja duhet të komunikoj dhe bart këtë vendim tek të gjithë organet përkatëse hetimore dhe prokuroriale të Misionit (shih paragrafin 1(b)-(c) dhe (e) më sipër), ShM-ja ka thënë si në vijim:

“... Kam për qëllim të komunikoj vendimin tek të gjithë organet përkatëse hetimore dhe prokuroriale të Misionit, në veçanti tek prokurorët e EULEX-it, të cilët në fund mbeten përgjegjës për të vlerësuar nëse ekzistojnë rrethanat e jashtëzakonshme që do ta arsyetonin marrjen përsipër të një lënde të veçantë”.

6. Paneli është i kënaqur që kjo e zbaton plotësisht rekomandimin e Panelit në këtë pikë. Në veçanti, komunikimi i vendimit të Panelit tek prokurorët e EULEX-it do të ndihmojë që të mundësohet se gjatë interpretimit të nocionin “rrethanat e jashtëzakonshme”, ata t’i marrin me vëmendjen e duhur faktorët e identifikuar nga Paneli si të rëndësishme nga pikëpamja e ligjit të të drejtave të njeriut për këtë hetim. Gjithashtu kjo do të jetë e qartë për prokurorët e EULEX-it nga vendimi i Panelit që çfarë rëndësie ligji i drejtave të njeriut i jep mënyrës se si viktimat e shkeljeve të të drejtave duhet të trajtohen.

7. ShM-ja gjithashtu ka theksuar si në vijim:

“E kam miratuar themelimin e një Rrjeti Kontaktues për të Drejtat e Njeriut brenda Misionit për të siguruar zbatueshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e divizioneve. Ky rrjet do të shërbejë si mekanizëm për të drejtat kryesore të njeriut në zbatimin e mandatit të Misionit dhe do të punojë për të siguruar një rishikim të procedurave dhe udhëzimeve që aktualisht janë në fuqi. E marr përsipër që t’ju informoj rreth rezultateve lidhur me rishikimin e brendshëm dhe konsultimet dhe nevojën për udhëzime të tilla.

Për më tepër do ta dërgoj përmes Komandantit të Operacioneve Civile vendimin e Panelit tek shtetet anëtare, të cilat janë përgjegjëse për burimet që i janë dhënë Misionit dhe njërive të veçanta në kuadër të misionit”.

8. Paneli është i inkurajuar dhe lavdëron ShM-në për vendimin e saj për të themeluar Rrjetin Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar zbatueshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e divizioneve. Ky plan duhet të ndihmojë që të bashkërendohej përpjekjet në kuadër të Misionit për të garantuar të drejtat e njeriut në kontekstin e mandatit ekzekutiv të Misionit dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në mbrojtjen efektive të këtyre të drejtave.

9. Paneli po ashtu kishte rekomanduar që ShM-ja duhet t’i udhëzoj organet hetimore të EULEX-it mbi rëndësinë e rasteve të zhdukjeve që të jenë prioritet i hetimeve (shih par. 1(d) më lartë). Përderisa ShM-ja nuk e ka adresuar shprehimisht këtë rekomandim, vendimi i Panelit i ishte komunikuar siç duhej prokurorëve të EULEX-it, kështu që Paneli është i bindur që shqetësimi i tij kishte kaluar me kohë dhe siç duhej tek organet kompetente të Misionit.

10. Sa i përket burimeve të Misionit (shih par. 1(f) më lartë), Paneli mirëpret hapin e ndërmarrë nga ShM-ja që të përcjellë vendimin e Panelit tek shtetet anëtare në mënyrë që për këtë qëllim ata të mund të kenë

parasysh obligimet lidhur me të drejtat e njeriut të Misionit gjatë caktimit të burimeve.

## **PRANDAJ PANELI NJËZËRI**

*Deklaron* se ShM-ja ka zbatuar rekomandimet e tij në këtë lëndë vetëm pjesërisht,

*Mirëpret* shenjën që është dhënë nga ShM-ja se ajo do të njoftoj Panelin lidhur me rezultatin e shqyrtimit të brendshëm dhe pret që së shpejti të merr këtë informacion,

*Vendos* të mbyllur shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese